

SHPLLJE

TERMAT E REFERENCËS

Organizata	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi te Kufizuar)
Qëllimi i Angazhimit	Handikos Ferizaj shpall thirrje publike për angazhimin e një Konsulenti për Menaxhimin e Stresit dhe Mirëqenien Psikologjike, me kohëzgjatje prej dy (2) ditësh, në kuadër të aktiviteteve për fuqizimin e stafit dhe promovimin e mirëqenies psikologjike në vendin e punës. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Grant Institucional EJA- GI- 15”, i mbështetur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’ dhe bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.
Tipi	Individuale/ Kompani
Lokacioni	Ferizaj, Kosovë
Kohëzgjatja	4 ditë

Handikos Ferizaj

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Handikos-Ferizaj, punon për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri si dhe aktivisht lobon dhe mbron në nivel lokal të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i angazhimit të Konsulentit për Menaxhimin e Stresit dhe Mirëqenien Psikologjike është të mbështesë dhe fuqizojë stafin e Handikos Ferizaj në zhvillimin e aftësive praktike për menaxhimin e stresit, ruajtjen e mirëqenies emocionale dhe përballimin e sfidave të përditshme profesionale.

Përmes një programi dyditor interaktiv dhe praktik, konsulenti do të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e shëndetit mendor dhe mirëqenies psikologjike në vendin e punës, duke ofruar metoda dhe teknika efektive për identifikimin e faktorëve të stresit, menaxhimin e presionit emocional dhe parandalimin e lodhjes profesionale (burnout).

Angazhimi synon gjithashtu të promovojë një kulturë pune më mbështetëse, bashkëpunuese dhe pozitive, përmes forcimit të komunikimit, menaxhimit të emocioneve, rritjes së motivimit dhe zhvillimit të mekanizmave të shëndetshëm për përballimin e situatave sfiduese në punën me përfituesit dhe në aktivitetet e përditshme të organizatës.

Në përfundim të angazhimit, stafi pritet të jetë më i pajisur me njohuri dhe praktika konkrete për ruajtjen e balancës emocionale dhe profesionale, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien individuale, cilësinë e punës dhe funksionimin e përgjithshëm të organizatës.

Angazhimi synon ofrimin e sesioneve praktike dhe mbështetëse për stafin lidhur me:

- menaxhimin e stresit në punë,
- parandalimin e lodhjes profesionale (burnout),
- mirëqenien emocionale dhe psikologjike,
- teknikat e relaksimit dhe komunikimit pozitiv në ekip.

Një (1) Ekspert/e lokal;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitja e agjendës dhe materialeve të trajnimit;
- Facilitimi i sesioneve gjatë dy ditëve të angazhimit;
- Përdorimi i metodave interaktive dhe praktike;
- Përgatitja e raportit përfundimtar narrativ me rekomandime.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë universitare në Psikologji, Punë Sociale, Sociologji, ose fusha relevante;
- Përvojë në facilitimin e trajnimeve mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike;
- Aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- Përvoja me organizata të shoqërisë civile konsiderohet përparësi.

Kohëzgjatja dhe pritjet

Angazhimi i Konsulentit do të zgjasë gjithsej katër (4) ditë pune, të ndara në:

- **Dy (2) ditë** për përgatitjen e materialeve, metodologjisë dhe agjendës së punës;
- **Dy (2) ditë** për realizimin e sesioneve të fasilitimit/trajnimit me stafin e Handikos Ferizaj.

Gjatë angazhimit, konsulenti pritet të:

- Hartojë planin dhe metodologjinë e punës për sesionet;
- Përgatisë materiale praktike dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit;
- Realizojë sesione interaktive dhe gjithëpërfshirëse mbi menaxhimin e stresit dhe mirëqenien psikologjike;
- Ofron teknika praktike për menaxhimin e stresit, emocioneve dhe parandalimin e lodhjes profesionale;
- Facilitojë diskutime dhe ushtrime që nxisin bashkëpunimin, komunikimin dhe mirëqenien në vendin e punës;
- Përgatisë një raport të shkurtër përmbledhës me rekomandime dhe reflektime nga aktiviteti.

Konsulenti duhet të sigurojë një qasje profesionale, etike dhe të përshtatur me nevojat e stafit dhe natyrën e punës së organizatës.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë:

- CV-në profesionale të përditësuar;
- Letër motivimi/interesi për angazhimin;
- Dëshmi mbi përvojën profesionale në fushën e menaxhimit të stresit, mirëqenies psikologjike ose shëndetit mendor;
- Kopje të diplomës/universitare dhe certifikatave relevante;
- Propozim të shkurtër metodologjik për realizimin e sesioneve dyditore;
- Referenca ose dëshmi të angazhimeve të ngjashme të mëparshme (e preferueshme).
- Ofertën financiare e propozuar nga aplikuesi, e specifikuar për ditë pune.

Pagesa

Pagesa për Ekspert/e, do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësisë të kontraktuar;

Procedurat e aplikimit:

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në adresën e-mail:

prokurimihandikos@gmail.com, me subjektin: “Aplikoj për [emri i pozitës që aplikoni]”.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **31.05.2026 ora 23:59**

Vetëm kandidatët që përzgjidhen për listën e ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit, informacione të mëtejshme nuk ofrohen përmes telefonit.